

VENDIM
Nr. 649, datë 13.8.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË
BANESAVE INDIVIDUALE TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA
(PALLAT), NË BASHKITË SHIJAK DHE KURBIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 186 772 938 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Shijak dhe Kurbin.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi prej 90 172 938 (nëntëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale, për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi prej 96 600 000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak dhe Kurbin, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama